



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

NJËSIA PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE/ JEDINICA ZA UPRAVLJANJE LJUDSKIM RESURSIMA/
HUMAN RESOURCES MANAGEMENT UNIT

REPUBLIKË E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT/ MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA	
Nr. Nis: 02	Shenja klas: 11
Nr. Prot. Viti: 2494 / 2024	
Data: 10.05.2024	
Nenshkrimi:	
Prishtine	

Bazuar , në Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212, Nenin 80 dhe 81, të Ligjit për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Nr. 08/L-197, Ligjin Nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën, Ligji Nr. 08/L-196, për Pagat në Sektorin Publik dhe Udhëzimin Administrativ MFPT-NR. 01 /2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall :

KONKURS

Titulli i punës: Instrumentist, Violinist / e

Institucioni: Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve (AKKV) “Shota”

Kategoria funksionale: Krijues/e dhe performues/e i/e artit dhe kulturës -Profesional 3

Klasa e pozitës: K8

Koeficienti : 6.5

Data e njoftimit: 10.05.2024

Afati për aplikim: 11.05.2024 – 09.06.2024

Numri i referencës: RN00013988

Kodi: RPC0007527

Numri i kërkuar: 1

I përgjigjet: Udhëheqësit Artistik të AKKV-Shota

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit Artistik të AKKV-Shota, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Interpreton në shfaqjet/koncertet e Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota";
2. Instrumentisti në ansambël obligohet që përveç instrumentit kryesor, të luaj edhe në së paku, dy instrumente të familjes së njëjtë apo të ngjashme;
3. Duhet të harmonizohet me orkestrën, me grupin e valleve, apo të këngëtarëve, respektivisht korit;
4. Kryen detyra profesionale sipas pozicionimit në orkestër;
5. Instrumentisti i nënshtrohet vlerësimit artistik, në mënyrë periodike, sipas dispozitave të parapara ligjore.
6. Anëtarët e orkestrës së rregullt, të ansambllit të përgatitur profesionalisht për interpretim solo dhe tutti.

Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik

Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë:

- 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe
- 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Duhet të ketë diplomë universitare Fakultetin e muzikës -dega instrumental violinë;
2. Njohuri të dhura lidhur me profesionin e instrumentistit
3. Aftësi për të punuar në grup me instrumentistë të tjerë në orkestër;
4. Shkathtësi të mira komunikuese dhe i gatshëm të punoj me orar fleksibil;
5. Përvoja në formacione orkestrale dhe koncertale është përparësi;
6. Vërtetimi që nuk është nën hetime.

Titulli i punës: Këngëtar / Solist/ Korsit

Institucioni: Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve (AKKV) “Shota”

Kategoria funksionale: Krijues/e dhe performues/e i/e artit dhe kulturës -Profesional 2

Klasa e pozitës: K7

Koeficienti : 7.5

Numri i kërkuar: 1

I përgjigjet: Udhëheqësit Artistik të AKKV-Shota

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit Artistik të AKKV-Shota, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Këndon në paraqitjet/koncertet e Ansambli Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” sipas kërkesave të ansambli;
2. Përveç paraqitjeve solo, është pjesëtar i /e rregullt i korit të ansambli.
3. Duhet të harmonizohet me orkestrën, me grupin e valleve, apo të këngëtarëve, respektivisht korit;
4. Të ketë njohuri dhe afirmitet të interpretimit të këngëve popullore e folklorike si dhe të këndimit koral, të lexojë notat muzikore.
5. I nënshtrohet vlerësimit artistik, në mënyrë periodike, sipas dispozitave të parapara ligjore.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Duhet të ketë diplomë universitare në Fakultetin e Arteve – Dega e Muzikës
2. Njohuri të duhura lidhur me profesionin e këngëtarit
3. Aftësi për të punuar në grup me koristë të tjerë dhe orkestrën;
4. Shkathtësi të mira komunikuese dhe i gatshëm të punoj me orar fleksibil;
5. Vërtetimi që nuk është nën hetime.

Titulli i punës: Korepetitor

Institucioni: Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve (AKKV) "Shota"

Kategoria funksionale: Krijues/e dhe performues/e i/e artit dhe kulturës - Drejtues/e i/e Lartë 3

Klasa e pozitës: K3

Koeficienti : 11

Numri i kërkuar: 1

I përgjigjet: Udhëheqësit Artistik të AKKV-Shota

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit Artistik të AKKV-Shota, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme

1. Punon direkt me trupën e valltarëve dhe kujdeset për ngritjen e nivelit artistik dhe fizik të tyre.
3. Të gjithë valltarëve, ua mëson pjesët koreografike dhe pjesët solistike.
6. Obligohet që ti ndjek të gjitha shfaqjet e ansamblit dhe të bëj vrojtimin dhe vlerësimin e pjesës skenike për secilën shfaqje.
7. Çdo koreografi që punohet nga koreografë të ndryshëm për ansamblin, kalon në
2. Kujdeset për ngritjen e cilësisë artistike të veprës koreografike. kompetencë të
4. Bën përzgjedhjen e trupës së valltarëve dhe solistëve për ekzekutimin e koreografisë.
5. Bën rivënien në skenë të koreografive të reja, po ashtu edhe të koreografive të punuara më parë që gjinden në repertorin e ansamblit. plotë të koreopetitorit.
8. Në mungesë të udhëheqësit artistik, në bashkëpunim me udhëheqësin e orkestrës është përgjegjës për drejtimin e trupës artistike.
9. Përgatitet për paraqitje në skenë, (përgatitja e kostumit, ngrohja provat vokale, teknike dhe dukja personale).
10. Bashkëpunon ngushtë me asistentët e grupit të valleve, për mbarëvajtje të programit.
11. Me kërkesë të drejtorit kryen edhe punë të tjera në këtë lëmi dhe sipas nevojës së programit, duhet të jetë i gatshëm të punojë edhe pas orarit zyrtar të punës.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Të ketë të mbaruar Fakultetin e Arteve, Dega e Koreografisë.
2. Të ketë së paku dy (2) vite përvojë punë në këtë profesion.
3. Të ketë njohuri mbi repertorin e AKKV "Shota".
4. Të ketë aftësi organizative dhe drejtuese.
5. Ta njeh mire profesionin e korepetitorit.
6. Vërtetimi që nuk është nën hetime.

Procedurat e konkurimit: Përzgjedhja e Instrumentist, Këngëtar dhe Korepetitor në AKKV "Shota" bëhet përmes procedurës së audicionit.

Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është pa afat të caktuar.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Data e njoftimit për aplikim në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt.11.05.2024 deri me dt.09.06.2024.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në Web faqen e MKRS-se.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit , ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil e administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211921 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).